

Ekspoze për Raportin vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë

Raportit për Gjendjen e Mjedisit në Kosovë, është bazuar në Ligjin e Mbrojtjes së Mjedisit. Sipas nenit 25, të këtij Ligji, Qeveria e Kosovës, me propozim të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, i paraqet Kuvendit Raport për Gjendjen e Mjedisit.

Bazuar në kërkesat ligjore Raporti përmban të dhëna për:

- gjendjen e mjedisit dhe ndryshimet në mjedis në krahasim me raportin e mëparshëm,
- ndikimet mjedisore në shëndetin e popullatës,
- gjendjen e mjedisëve të rrezikuara,
- zbatimin e Strategjisë së Mjedisit, Planit të Veprimit,
- masat e ndërmarra për mbrojtjen e mjedisit,
- financimin e sistemit për mbrojtjen e mjedisit. Etj.

Ky Raport vjetor paraqet gjendjen e mjedisit kryesisht për vitin 2016, por ka edhe të dhëna të mëhershme me qëllim krahasimi dhe prezantim të trendit.

Për hartimin e raporti, janë grumbulluar të dhëna nga sistemi i monitorimit të mjedisit, nga institucionet që kanë përgjegjësi në prodhimin e të dhënave për çështje të caktuara mjedisore, nga kompanitë, operatorët, ndërmarrjet e ndryshme, publikimet, raportet dhe nga burime tjera.

Qëllimi i këtij raporti, në radhë të parë është, informimi i politkëbërësve (Qeverisë së Kosovës dhe Parlamentit të Kosovës) për gjendjen e mjedisit me qëllim të nxitjes së hartimit të politikave adekuate mjedisore dhe për orientimin e zhvillimeve, planifikimeve dhe investimeve strategjike në sektorët të cilët kanë ndikim në mjedis sikur janë: ekonomia, industria, energjetika, transporti, bujqësia etj.

Të gjeturat kryesore të raportit tregojnë se:

- Sa i përket cilësisë së ajrit konstatohet se tejkalimet më të shpeshta të vlerave limite janë regjistruar për Grimcat e PM10 dhe PM2.5 (në Prishtrinë, Obiliq e Drenas), ndërsa që ka pasur raste te tejkalimeve edhe për vlerat limite të Ozonit, CO, NOx. Krahasuar me vitin 2015, nuk vërehet ndonjë ndryshim në cilësinë e ajrit. Njëjtë sikurse gjatë vitit 2015 edhe gjatë vitit 2016, tejkalime janë regjistruar kryesisht për parametrat PM10 dhe PM2.5.
- Treguesit e **cilësisë së ujarëve** vlerësojnë se përkundër faktit që ka trend të rritjes së ndikimit në cilësinë e ujit në disa nga pellgjet lumore, sidomos nga ndikimi i mungesës së trajtimit të ujërave (rritja e vlerave të shpenzimi kimik i oksigjenit SHKO), ujërat sipërfaqësore në Kosovës nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi. Në sektorin e ujërave shqetësues është rritja e trendit të shfrytëzimit të pakontrolluar të inerteve nga shtretërit e lumenjve dhe shkatërrimi i tyre.

- Parametrat e **ndotjes së tokave** tregojnë se në toka bujqësore, rezultatet janë brenda standardeve të ndotjes së tokës dhe se rastet e identifikuar me ndotje me metale të rënda janë kryesisht në zonat industriale. Shqetësues është fakti lidhur me trendin e rritjes së ndryshimit të destinimit të tokave bujqësore në zona ndërtimore dhe industriale.
- Vazhdon trendi i rritjes së gjenerimit të mbeturinave dhe sasisë së mbeturinave të deponuara ndërkohë që është shënuar progres në eliminimin e deponive ilegale nga komunat por jo edhe në menaxhimin e deponive sanitare nga kompanitë përkatëse. Ende nuk ka sistem të riciklimit të mbeturinave dhe as sistem të rimbursimit të ambalazhit.
- Ka trend pozitiv në rritjen e sipërfaqeve të **zonave të mbrojtura** edhe pse ndikimet në zonat e mbrojtura janë evidente. Gjatë vitit 2016 janë marrë në mbrojtje 67 zona të reja të natyrës. Megjithkëtë ndikimi në zonat e mbrojtura dhe në biodiversitet është evident për shkak të ndërtimeve ilegale, prerjeve të pakontrolluara dhe gjuetisë ilegale.
- Niveli i Zbatimit të Strategjisë Mjedisore të Kosovës, strategjive dhe planeve sektoriale nuk është i plotë, në mungesë të buxhetit për realizimin e projekteve të propozuara dhe arritjen e objektivave përkatëse. Kosova aktualisht nuk ka Strategji dhe Plan Kombëtar të Mbrojtjes së Mjedisit të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës, meqenëse Strategjisë dhe Planit të kaluar ka qenë në fuqi vetëm deri në viti 2015. Po ashtu ende nuk është miratuar as Strategjia Kombëtare e Ujërave.
- Në kuadër të reagimeve dhe masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit, është shënuar progres modest në hartimi i legjislacionit mjedisor dhe transpozimi i tij me direktivat e BE, përmirësimin e inspektimit, kontrollit dhe monitorimit të mjedisit, rregullimin e shtretërve të lumenjve, dhe realizimin e projekteve mjedisore me donatorë.
- Krahasuar me vitin paraprak në vitin 2016, **buxheti** i dedikuar për MMPH ka pasur një rritje të ndjeshme (Tabela 1). Mirëpo një nga problemet që duhet përmendur është fakti se buxheti për shpenzime kapitale në shumë raste nuk orientohet në projekte mjedisore por në projekte tjera që realizimi i tyre nuk ka ndikim në përmirësimin e mjedisit.

Tabela 1: Buxheti i MMPH 2015-2016

Buxheti MMPH	2015	2016
Shpenzime kapitale	34,901,813 €	35,903,684 €
Buxheti Total	38,043,185 €	39,357,027 €

Raporti sjellë edhe këto rekomandime:

- **Ajri:** Rekomandohet të kompletohet inventari i emisioneve dhe burimeve të ndotësve në ajër, të funksionalizohet plotësisht sistemi nacional për monitorimit e cilësisë së ajrit dhe të zbatohet sistemi i online (në kohë reale) i raportimit të të dhënave për cilësinë e ajrit. Të implementohet Strategjia dhe Plani i Veprimit për Cilësinë e Ajrit, dhe dokumentet tjera strategjike për këtë sektor, duke përfshirë edhe Planet e Veprimit në Nivelin e Komunave.
- **Uji-** Të ngritet sistemi për monitorimin e cilësisë së ujërave nëntokësore si dhe të bëhet monitorimi i statusit ekologjik të ujërave sipërfaqësore. Të vazhdohet me ngritjen e infrastrukturës ujore, sikurse janë impianteve për trajtimin e ujërave të ndotura me qëllim të ruajtjes së cilësisë së ujërave sipërfaqësore. T'i kushtohet vëmendje edhe adaptimit ndaj ndryshimeve klimatike në sektorin e ujërave dhe të miratohet Strategjia Kombëtare për Ujëra.
- **Toka-** Të monitorohen të ashtuquajturat “hotspotet mjedisore-zonat e rrezikuara” dhe të investohet në rehabilitimi i tyre. Te hartohet programi i monitorimit të tokave bujqësore dhe atyre industriale, dhe të hartohen politikat të favorshme për menaxhimin e qëndrueshëm të të tokave dhe përdorimin e tyre.
- **Biodiversiteti dhe zonat e mbrojtura-** Të bëhet monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes së zonave të mbrojtura, të llojeve të rralla dhe të rrezikuara bimore dhe shtazore. Të filloj përgatitja e arsytimit profesional për shpalljen e zonave të mbrojtura të zogjve dhe habitateve sipas rrjetit ekologjik Natyra 2000. Të themelohen organet menaxhuese për zonat e mbrojtura si dhe të hartohen dokumentet përkatëse planifikuese për këto zona.
- **Mbeturinat-** Me qëllim të përmirësimit të sistemit për menaxhimin e mbeturinave rekomandohet që përveç implementimit të Strategjive dhe Planeve në sektorin e mbeturinave të punohet edhe më tutje në fuqizimin e institucioneve qendrore, lokale dhe kompanive për menaxhimin e mbeturinave, në hartimin dhe zbatimin i projekteve, planeve dhe programeve për riciklimin, trajtimin dhe ripërdorimin e mbeturinave dhe në ngritjen e vetëdijesimit.
- **Rekomandime tjera;** Të rritet buxheti për sektorin e mbrojtjes së mjedisit. Të vazhdohet me investime në prodhimin e energjisë së ripërtitshme, të promovohet dhe mbështetet edhe më shumë efienca e energjisë si dhe të respektohen kriteret dhe standardet mjedisore në procesin e ndërtimit të kapaciteteve të reja energjetike. Është nevojë emergjente themelimi i ekofondit dhe destinimi i mjeteve të tij në projekte mjedisore.

Duke u bazuar në të dhënat e prezantuara, në të gjeturat kyçe të Raportit dhe në rekomandimet që jep raporti, ju ftoj që të mbështesni këtë raport dhe këto rekomandime me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të mjedisit dhe gjendjes mjedisore.